



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

BULETINI

Prill – Qershor 2024



Përmes këtij buletini pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për periudhën kohore Prill-Qershor 2024

Kryeprokurori Enis Gashi dhe prokurori Kastriot Memaj, pritën në takim z. Vesa Satamo, nga Njësia për Monitorimin e Krimeve të Mjedisit në EULEX

Gjakovë, 3 prill 2024 – Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, z. Enis Gashi, së bashku me prokurorin koordinator për veprat penale kundër mjedisit z. Kastriot Memaj, pritën në takim z. Vesa Satamo, nga Njësia për Monitorimin e Krimeve të Mjedisit në EULEX. Në këtë takim të rëndësishëm, diskutuan për menaxhimin dhe performancën e prokurorisë në lidhje me trajtimin e rasteve të veprave penale kundër mjedisit se si përballen me rastet konkrete dhe hapat që janë ndërmarrë ndajë kryerësve të këtyre veprave penale, duke përfshirë sfidat dhe arritjet e prokurorisë.

z. Gashi dhe z. Memaj e njoftuan z. Satamo, se veprat penal kundër mjedisit trajtohen me prioritet dhe se ndaj personave të përfshirë janë ngritur aktakuza, si dhe janë sekuestruar mjetet e punës me të cilat janë kryer këto vepra penale.

Në koordinim të ngushtë me policinë, prokurorët kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin e ligjit dhe për të garantuar që personat e përfshirë në veprat penale kundër mjedisit të përballen me përgjegjësi ligjore për veprimet e tyre.

Takimi ishte një rast i rëndësishëm për shkëmbimin e informacioneve dhe koordinimin e veprimeve në mbrojtje të mjedisit dhe zbatimit të ligjit, z. Satamo vlerësoi angazhimin dhe përpjekjet e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, në këtë drejtim dhe shprehu gatishmëri për të ndihmuar në luftën kundër kryerësve të këtyre veprave penale.



Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge

Gjakovë, 4 prill 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet XH.B., ka marrë Aktvendim për fillimin e hetimeve si dhe ka paraqitur, kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri në shtëpinë e tij, pa autorizim dhe me qëllim të shitjes apo shpërndarjes ka poseduar substanca apo preparate të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, substance psikotrope dhe analoge, gjatë kontrollit të shtëpisë janë gjetur dhe sekuestruar pesë qese plastike me substancë të dyshuar për narkotik të llojit kokainë, po ashtu në oborrin e shtëpisë janë gjetur dhe sekuestruar tri qese plastike me substancë të dyshuar për narkotik të llojit kokainë, një peshore digjitale si dhe katër telefona mobil, të gjitha të sekuestruar dhe me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.2 të KPRK-së.


Aktakuzë kundër një personi për veprën penale vrasje

Gjakovë, 19 prill 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit D.LL., për shkak të veprës penale Vrasje nga neni 30 par.2 pika 3 të LPK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri D.LL., me dt.12.07.2003, rreth orës 09:00, në fshatin Raçë, Komuna Gjakovë, në afërsi të dyqanit “V...”, me dashje e nga gjakmarrja ka privuar nga jeta N.N., i moshës 47 vjeçare, nga fshati Raçë, Komuna Gjakovë, në atë mënyrë që për shkak të vrasjes së babait të tij, të cilin para 12 vitesh e kishte privuar nga jeta i ndjeri N.N., ditën kritike i pandehuri, shkon në vendin e lartcekur me veturën e tij Golf 3, ngjyrë e kuqe, duke i përcjellë lëvizjet e tani të ndjerit dhe kur i njëjti ka hyrë në dyqan “V...”, për të blerë ca gjëra ushqimore, i pandehuri D.LL., e pret e me të vërejtur se del nga dyqani prej një afërsie shtënë në drejtim të tij 28 herë në pjesë të ndryshme të trupit, dhe kur viktimë bie përtokë, i pandehuri përsëri shtënë në drejtim të kokës së viktimës, duke i shkaktuar plagë të shumta me armë në kokë, gjoks dhe gjymtyrë, nga plagët e marra viktimë ka mbetur i vdekur në vendin e ngjarjes.

I pandehuri nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale ka qenë në arrati. I njëjti është arrestuar me urdhër arrest ndërkombëtar dhe është ekstraduar nga SHBA në Kosovë.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.



Kryeprokurori z. Enis Gashi, priti në takim zyrtarët policor nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë

Gjakovë, 2 maj 2024, Kryeprokurori z. Enis Gashi, së bashku me prokurorët e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, priti në takim shefat e sektorit të hetimeve të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjakovës dhe Stacioneve Policore të kësaj drejtorie.

Tema kryesore e këtij takimi të rëndësishëm ishte koordinimi për kryerjen e detyrave dhe sfidat e ndryshme që paraqiten në punën e përbashkët, identifikimin dhe adresimin e sfidave aktuale që ndikojnë në stabilitetin dhe rendin publik në rajonin tonë.

Të pranishmit u dakorduan për rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinim efektiv mes autoriteteve ligj zbatuese për të zgjidhur rastet dhe për të parandaluar rreziqet potenciale për sigurinë publike. Diskutimet dhe analizat e detajuara të situatës ndihmuan në identifikimin e strategjive më efikase për të adresuar çështjet e rëndësishme të sigurisë publike dhe për të arritur sukses në misionin tonë.

Ky bashkëpunim i ngushtë mes prokurorisë dhe autoriteteve policore vazhdon të jetë thelbësor për mbrojtjen e qytetarëve, kështu duke mbetur të përkushtuar në përmirësimin e efikasitetit tonë dhe në sigurimin e një ambienti sa më të sigurt.



Vizita e Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, në Prokurorinë Themelore në Gjakovë

Gjakovë, 3 maj 2024, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, së bashku me anëtarin e Këshillit Prokurorial, z. Armend Zenelaj, realizuan një vizitë pune në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Gjatë kësaj vizite, ata u pritën nga Kryeprokurori, Z. Enis Gashi, dhe Zëvendës Kryeprokurori, z. Sadri Alija.

Gjatë takimit, Kryeprokurori z.Gashi dhe Zëvendës Kryeprokurori z.Alija informuan Kryesuesin z.Hajdaraj për aktivitetet dhe arritjet e punës në tremujorin e parë të vitit 2024, duke përfshirë sfidat dhe vështirësitë e hasura gjatë hetimeve dhe ndjekjes së veprave penale në juridiksionin e tyre.

Kryesuesi Hajdaraj theksoi rëndësinë e këtyre vizitave për njohjen e drejtpërdrejtë të proceseve aktuale të punës dhe për të diskutuar nevojat për zbatimin efektiv të mandateve kushtetuese dhe ligjore të prokurorive.



Kërkohet paraburgimi ndaj të dyshuarit për veprën penale ngacmim seksual në vazhdimësi

Gjakovë, 10 maj 2024, Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, njofton opinionin publik se ndaj të pandehurit me inicialet A.D., ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve dhe ka paraqitur kërkesë, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, ndër të tjera ceket se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me inicialet A.D., nga muaji Dhjetor i vitit 2023 e deri me dt.08.05.2024, në Gjakovë, e ngacmon seksualisht në vazhdimësi personin e dobët të dëmtuarën/e mitur, në formë të sjelljes së padëshiruar verbale dhe jo verbale të natyrës seksuale me qëllim të cenimit të dinjitetit, në atë mënyrë që pasi që i pandehuri dhe e dëmtuara/e mitur ishin njoftuar përmes rrjeteve sociale, i dërgon mesazhe të natyrës seksuale, me të cilat veprime të dëmtuarës ia cenon dinjitetin dhe tek e njëjta krijon një mjedis i cili objektivisht është frikësues, degradues dhe poshtërues.

Me këto veprime formohet dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, ngacmim seksual në vazhdimësi nga neni 10 i Ligjit Nr.8/L-188 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit 06/L – 074 Penal të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 183 par.4 lidhur me par.2, e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, sekuestron mjetet me të cilat është Degraduar dhe Shkatërruar Mjedisit

Gjakovë, 17 maj 2024 - Prokuroria Themelore në Gjakovë, njofton opinionin publik se pas një inspektimi të kryer nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ka konstatuar se në disa fshatra të Komunës së Rahovecit, është duke u degraduar ambienti për shkak të aktivitetit ilegal të nxjerrjes së zhavorrit përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë.

Prokurori koordinator për hetimin e Krimeve Kundër Mjedisit, z. Kastriot Memaj, ka urdhëruar inicimin e rastit për veprën penale "Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit" nga neni 338 i KPRK-së.

Po ashtu, është urdhëruar sekuestrimi i një kamioni transportues dhe një ekskavatori si mjete të përdorura në kryerjen e veprës penale.

Njëkohësisht, në koordinim me policinë, janë duke u ndërmarrë veprime aktive me drejtim të kapjes së kryesve të kësaj vepre penale.

Prokuroria e njofton opinionin publik se mbetet e përkushtuar maksimalisht në luftimin e dukurive të tilla të kundërligjshme që degradojnë ambientin dhe u bën thirrje qytetarëve për bashkëpunim në luftimin e këtyre dukurive.




Vazhdon aksioni i sekuestrimit të mjeteve me të cilat ilegalisht po nxirrej zhavorr përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë

Gjakovë, 20 maj 2024 - Prokuroria Themelore në Gjakovë, njofton opinionin publik se aksioni për sekuestrimin e mjeteve të përdorura për degradimin dhe shkatërrimin e mjedisit është në vazhdim.

Pas një inspektimi të kryer nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, është konstatuar se në disa fshatra të Komunës së Rahovecit, ambienti po degradohet për shkak të aktivitetit ilegal të nxjerrjes së zhavorrit përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë.

Prokurori koordinator për hetimin e Krimeve Kundër Mjedisit, ka urdhëruar inicimin e rastit për veprën penale "Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit" nga neni 338 i KPRK-së. Gjithashtu, është urdhëruar sekuestrimi i një (1) kamioni transportues, tre (3) ekskavatorëve dhe një (1) seperacioni me të gjitha pajisjet përcjellëse të përdorura në kryerjen e veprës penale. Prokuroria njofton se aksioni për sekuestrimin e mjeteve të përdorura në aktivitete e paligjshme do të vazhdojë deri në kapjen e të gjitha mjeteve dhe personave përgjegjës. Prokuroria e njofton opinionin publik se mbetet e përkushtuar maksimalisht në luftimin e dukurive të tilla të kundërligjshme që degradojnë ambientin dhe u bën thirrje qytetarëve për bashkëpunim në luftimin e këtyre dukurive.





Kryeprokurori Enis Gashi, mbajti takim falënderimi për kontributin dhe punën e prokurorit Kastriot Memaj në Prokurorinë Themelore Gjakovë

Gjakovë, 31 maj 2024 - Prokuroria Themelore Gjakovë, ka organizuar takim përshëndetës dhe falënderues me rastin e avancimit të prokurorit Kastriot Memaj nga Prokuroria Themelore Gjakovë, në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, Kryeprokurori në emër të Prokurorisë Themelore Gjakovë, ka ndarë mirënjohje dhe ka falënderuar të njëjtin për punën dhe angazhimin e tij në pozitën e prokurorit të shtetit në këtë prokurori, duke i uruar shëndet dhe sukses në vazhdimin e karrierës profesionale.



Aktakuzë kundër dy personave për veprat penale vrasje e rëndë në tentativë, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve dhe ndihma në kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë

Gjakovë, 24 qershor 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit Sh.A., për veprat penale “Vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin J.M., për veprën penale “Ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së.

Sipas pikës I të dispozitivit të aktakuzës, ndër tjera cekët se i pandehuri Sh.A., Me datë 10.03.2024 në ora 00:13 në Gjakovë, në restorantin “R...”, me dashje ka tentuar ti privoj nga jeta të dëmtuarit D.S., J.S., dhe F.Zh., që të tre nga Gjakova.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Sipas pikës II të dispozitivit të aktakuzës, ndër tjera cekët se i pandehuri Sh.A., ka mbajtur në posedim të paautorizuar armën, në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par.1.1 Ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sipas pikës III të dispozitivit të aktakuzës, ndër tjera cekët se i pandehuri J.M., me dashje ndihmon të pandehurin Sh.A., duke ia dërguar mjetin e kryerjes së veprës penale – armën të cilën i pandehuri J.M., e posedonte me leje.

Me këto veprime i njëjti ka kryer veprën penale “Ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173 par.1 nën par.1.5 e lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat ju vihen në barrë.